

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	01-3442/14
Dep.	03.10.2014
Nr. I faq.	02
Broj stranica	
Nr. pages	
Dok. SHTINE	
Nr. Prot.	
Br. Prot.	
Prot No.	
Data	
Datum	
Date	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupcionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupcionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupcionit me datë 01.10.2014 mori:

V E N D I M

I. Ekziston konflikti i interesit në ushtrimin e funksionit publik në rastin me nr. AKK -03-1725/14, për z. Flamur Keqa - Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe njëkohësisht Anëtar i Bordit Drejtues në Fondin e Kursimeve Pensionale.

II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.

III. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.

IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051 (në tekstin e mëtejmë Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), neni 18 (paragrafi 1 dhe 3), nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi, është inicuar rasti për zyrtarin e lartë Flamur Keqa i cili ushtron dy funksione publike: Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe njëkohësisht, Anëtar i Bordit Drejtues në Fondin e Kursimeve Pensionale.

Fillimi i zyrtarit i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupcionit, për fillimin e shqyrimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkresë, ashtu siç parashihet me ligj, brenda afatit 15 ditor, z. Keqa është takuar me zyrtarët e

AKK-së. Në këtë takim e kemi njoftuar me faktet që posedon Agjencia për këtë rast, në lidhje me situatën mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtarit të lartë z. Keqa i është bërë e ditur se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, nuk mund të ushtroj funksionin e anëtarit të Bordit Drejtues në Fondin e Kursimeve Pensionale. Kjo për faktin se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051) e ndalon një gjë të tillë.

Neni 16 (paragafi 1) i këtij ligji shprehimisht thotë:

“Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak te funksionit”.

Bazuar në këtë dispozitë, Agjencia, përmes shkresës paralajmëruese, e ka njoftuar z. Flamur Keqa, se nuk mund të ushtroj këto dy funksione njëkohësisht dhe se duhet të zgjedhë njërin prej tyre. Për shmangjen e konfliktit të interesit Agjencia i ka dhënë një afat, mirëpo, z. Keqa nuk e ka përfillur këtë afat dhe deri më sot nuk ka ndërmarr asnje veprim për t'u larguar nga njëri prej funksioneve.

II. Agjencia do të kërkoj nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që të filloj procedurën për shkarkimin e tij. Kjo bazuar në nenin 18 (pika 8) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit i cili thotë: *“Në rast se personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij”.*

III. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, *“Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuuar në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3”*.

Sipas Nenit 20 pika 2, *“Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtarit të lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç denimit gjykata mund t'i shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit”*.

IV. Sipas Nenit 18 paragafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

